

FEDERATA E KARATESË E KOSOVËS
KOSOVA KARATE FEDERATION



RREGULLOREN PËR PËRZGJEDHJEN E
SPORTISTËVE, TRENEREVE DHE PUNËTORËVE
SPORTIV

Prishtinë, 2022

Në bazë të Nenit 7 Pika 3 (f) të Statutit të Federatës së Karatesë së Kosovës, Bordi i Federatës së Karatesë së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12.07.2022 miratoj

RREGULLOREN PËR PËRZGJEDHJEN E SPORTISTËVE, TRENERËVE DHE PUNËTORVE SPORTIV

NENI 1

Me këtë rregullore, Bordi i Federatës i përcakton kriteret për zgjedjen e sportistit, klubit dhe trajnerit të vitit nga garat e karatesë.

Federata për çdo vit bën shpalljen e:

- a. Dhjetë (10) sportistëve, (nga seniorët);
- b. Pesë (10) sportistëve, (nga juniorët);
- c. Pesë (10) sportistëve, (nga kadetët);
- d. Nga moshë 7-14 vjeç në secilën kategori nga Pesë (5) sportist;
- e. Tri (3) klubet më të suksesshme në secilën kategori, Grupmosha, Kadet&Junior dhe Senior;
- f. Tre (3) trajner të suksesshëm për: Grupmosha 7-14 vjeç ,Kadet&Junior dhe Senior;
- g. Pesë (5) punëtor dhe kontribues sportiv në nivel vendi dhe diasporë;
- h. Sponzor e donator të vullnetit të mirë.

NENI 2

Në konkurrencen për zgjedhjen e sportistit të vitit hyjnë të gjithë sportistët të cilët gjatë vitit kalendarik kanë bërë gara në konkurrencen e seniorëve, juniorëve dhe grupëmoshave.

- a. Sportistët të cilët gjatë vitit kanë marrë denimin më të rëndë (SHIKAKU), ose ndaj të cilëve zhvillohet procedurë disiplinore nga komisioni përkatës i Federatës, apo procedurë penale nga organet kompetente shtetërore, **NUK** mund të hyjnë në konkurrencën për përzgjedhjen e sportistit të vitit.
- b. Klubi i cili ka marrë denimin SHIKAKU nuk mund të hyjë në konkurrencë për përzgjedhje.
- c. Treneri i cili ka marrë SHIKAKU nuk mund të hyjë në konkurrencë për përzgjedhje.
- d. Në konkurrencën për zgjedhjen e sportistit të vitit, **NUK** mund të hyjnë as sportistët, të cilët gjatë një viti kalendarik të garave, kanë marrë pjesë në më pak se 50% të garave zyrtare të dhe atyre vendore të Federatës, vetëm në rast se garuesi ka pasur ndërhyrje kirurgjike, operim apo lëndim të cilin me raport e miraton bordi i Federatës së Karatesë.

NENI 3

Kandidatët potencial për sportist të vitit, përveq rezultateve duhet ti përmbushin edhe këto kriteret:

1. Përfaqësim të denjë në gara kombëtare dhe ndërkombëtare.
2. Të kenë aftësi psiko fizike për tu marrë me sportin e karatesë.
3. Të kenë sjellje shembullore në gara dhe jashtë garave.

NENI 4

Vlerësimi bëhet në bazë të rezultateve të arritura në garat zyrtare nën organizimin e: FKK, FBK (WKF), MFKU (MFKU), FEK (EKF), FBK (WKF) dhe Lojërat Olimpike, Botërore, Evropiane dhe Mediterane të organizuara nën ombrellën e IOC- KOK-ut.

NENI 5

Garat zyrtare të FKK-së që llogariten në përzgjedhjen e sportistit janë:

- *Kampionati i Kosovës,*
- *Shpresat e Kosovës,*
- *Haki Iberdemaj,*
- *Xhevat Makolli*
- *Adem Jashari*
- *Kampionati Mbarëkombëtarë*

NENI 6

Sportistët marrin numër të caktuar të pikëve për rezultatet individuale të arritura në garat nga Neni 4 i kësaj rregulloreje, në bazë të të cilave pastaj renditen në mesin e sportistëve të suksesshëm për senior, kadet, junior dhe grupmosha në baze të pikëve si më poshtë:

NR.	EMRI I KAMPIONATIT	1	2	3	5	7	9
1	Lojrat Olimpike (IOC)	2500	2000	1500	1000	800	
2	Lojrat Botërore (IOC)	2000	1500	1000	800	600	
3	Kampionatet Botërore (WKF)	2000	1500	1000	800	600	400
3	Lojrat Evropiane (IOC)	1500	1200	900	700	500	
5	Kampionatet Evropiane (EKF)	1500	1200	900	700	500	
6	Lojrat Mesdhetare (IOC)	1000	800	600	400	200	
7	Kampionatët Mesdhetare (MFKU)	1000	800	600	400	200	
8	Kampionati Ballkanik (BKF)	600	500	400	200		
9	Premier League (WKF)	1000	800	600	400	200	
10	Series A (WKF)	600	500	400	300		
11	Youth League (WKF)	1000	800	600	400	200	
12	Kampionati Mbarëkombëtar	150	120	100			
13	Kampionati Shtetëror (FKK)	120	100	80			
14	Turnet zyrtare të FKK-së (FKK)	100	80	60			
15	Turnet e organizuara nga klubet	70	50	40			

Vërejtje:

Secili sportist/trajner dërgon 5 rezultatet më të mira pranë komisionit për përzgjedhje në kuader të FKK-së dhe nga ato rezultate bazuar në tabelen e lartë shënuar mblidhen piket dhe del lista e përzgjedhjes.

Ne rastet kur piket janë të njëjta do të vendoset nëse garuesi ka medale/renditje të nivelit më të lartë ndërkombëtar apo renditjes më të lartë në WKF Ranking ose për rastet të tilla komisioni e dërgon rastin në Bordin Ekzekutiv të FKK-se ku merret vendimi përfundimtar.

Trajnerin e vitit e tërheq automatikisht sportisti i kategorive të lartcekura.

NENI 7

Bordi i Federates mund të vendos me vendim të veçantë si çmim special, që edhe për kategoritë tjera të sportistëve të zgjidhen më të suksesshmit, si formë stimuluese për ato kategori, si p.sh:

- Për garuesit që arrijn rezultat në një garë ndërkombëtare, kurse në nivelin kombëtar nuk ka pikë të mjaftueshme për tu përzgjedhur.
- Veteranët që marrin pjesë në garat e ndryshme.
- Personat me aftësi të kufizuara.

NENI 8

Përzgjedhja bëhet:

- Nga Pesë (5) garues për secilën moshë nga mosha: 7 vjeç; 8 vjeç; 9 vjeç; 10 vjeç; U12 dhe U14, si më të suksesshmit, por nuk cilësohen si sportist të vitit.
- Dhjetë (10) nga grupmoshat kadet&junior si më të suksesshmit, por nuk cilësohen si sportist të vitit.
- Dhjetë (10) nga seniorët si më të suksesshmit dhe bëhet përzgjedhja e dy garuesve si sportist të vitit, një nga gjinia mashkullore dhe një nga gjinia femrore.

NENI 9

Zgjedhja e tri (3) klubeve më të suksesshme, bëhet duke u bazuar në totalin më të lartë të pikëve të fituara të klubeve nga garat e të gjitha niveleve si ato kombëtare po ashtu edhe nga ato ndërkombëtare në kategorinë e:

- Grupmoshave U7- U14 vjeçe
- Kadet & Junior U16
- Senior +18

NENI 10

Pesë (5), mirënjohje për punëtorët sportiv, kontribuesit e zhvillimit të sportit, kontribuesit (in memorian) etj, bëhen direkt nga komisioni i përzgjedhjes në bashkëpunim të ngushtë me Bordin e Federates së Karatesë.

NENI 11

Në rast se garuesi i mbush vitet e moshës apo grupmoshës më të lartë, por në kalendarin e garave të FKK-së nuk ka pasur aktivet, pikët e grumbulluara i mbesin në kategorinë të cilën ka marr pjesë.

Vërejtje: Nëse në kalendarin e garave të FFK-së ka pasur aktivitete dhe garuesi ka marr pjesë, atëhere pikët i kalojnë në grupmoshën më të lartë.

NENI 12

Përzgjedhjen e Referit/ve më të mirë e bënë Komisioni i Refereve

NENI 13

Formulari i plotësuar nga aplikuesit për përzgjedhjen e sportistëve / laureatëve

Formulari për nominim për përzgjedhjen e sportistëve dhe laureatëve të vitit	
Klubi	
Emri dhe mbiemri 1. Sportist 2. Trajner 3. Refer	
Data e lindjes së kandidatit të nominuar	
Adresa e kandidatit të nominuar	
Numri i telefonit dhe e-maili	
Nominimi lloj i nominimit dhe kategoria	
Rezultatet e arritura (5 rezultatet më të mira që tërheqin pikë bazuar në rregullorën e FKK-së)	1. 2. 3. 4. 5.
Emri dhe mbiemri i aplikuesit / trajnerit	
Nenshkrimi	
Data dhe Vendi	

Verejteje:

Bashkangjitur rezultateve duhet dërguar dhe dëshmit si kopjet e diplomave dhe rezultateve të shënuara (rangimet nga sportdata)

NENI 14

Përzgjedhja e sponsorëve dhe donatorëve bëhet nga Komisioni përzgjedhës në bashkëpunim të ngushtë me Bordin e FKK-së dhe administratën e FKK-së.

NENI 15

Dispozitat e kësaj rregulloreje janë objektivisht të zbatueshme nga Komisioni për zgjedhjen e sportistëve të vitit të FKK-së.

NENI 16

Shpjegimin dhe komentimin e kësaj rregulloreje e bënë Bordi i FKK-së.

NENI 17

Rregullorja për zgjedhjen e sportistit të vitit, bëhet e plotëfuqishme me ditën e miratimit nga Bordi i FKK-së dhe nënshkrimi nga kryetari i FKK-së.

Prishtinë, 12.07.2022

Avni Gashi

Kryetar

